



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT**  
**TË PËRGJITHSHËM DIBËR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Peshkopi, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**UDHËZIM I PËRGJITHSHËM**

Nr. 58 , datë 25.07 .2024

**PËR EFEKTIVITETIN E SHËRBIMIT TË GATISHMËRISË**

Unë **Abaz MUÇA**, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në mbështetje të neneve 42, 43, 46, pikat 1 dhe 4 dhe 52 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 4 dhe 5 të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”<sup>1</sup>, neneve 5, 7 e vijues të ligjit nr.25, të vitit 2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, të ndryshuar dhe udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr.8, datë 23.07.2024 “Për efektivitetin e shërbimit të gatishmërisë”,

**U D H Ë Z O J :**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për organizimin e shërbimit të gatishmërisë për të siguruar realizimin e detyrave të ngutshme që lidhen me hetimin dhe

<sup>1</sup> Miratuar me urdhërin nr.37, datë 25.03.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

ndjekjen penale dhe përdorimin e burimeve njerëzore apo infrastrukturës në përputhje me nevojat për realizimin e tyre.

## Neni 2 **Përkufizime**

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Shërbimi i Gatishmërisë” nënkupton mbajtjen në gjendje të tillë të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës, për të bërë të mundur zgjidhjen në kohë të problematikave të ngutshme të ndjekjes penale, brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës;

b) “Detyrë e ngutshme”, është çdo detyrë që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale, e asaj natyre, zgjidhja e së cilës nuk mund të presë ditën pasardhëse të punës.

## **KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GATISHMËRISË**

### Neni 3 **Masat e prokurorit**

Prokurori i caktuar për gatishmëri, organizon punën në mënyrë të tillë që aktiviteti i zakonshëm i tij të mos bëhet pengesë për ndjekjen e problematikës që mund të dalë gjatë këtij shërbimi.

a) Gjatë periudhës së gatishmërisë, prokurori përveç detyrave të tjera të ngutshme:

– Merr dijëni për veprat penale të ndodhura, me iniciativën e vet dhe me njoftimet e bëra nga të tjerët, duke mbajtur lidhje me shërbimet e policisë gjyqësore;

– Asiston në vendngjarje për veprat penale që me akte të tjera është parashikuar detyrimi i pjesëmarrjes apo kur çmon se për shkak të natyrës së ngjarjes pjesëmarrja është e domosdoshme;

– Merr njoftime për arrestime në flagrancë dhe ndalime, merr në pyetje të arrestuarit ose të ndaluarit dhe kontrollon ligjshmërinë e tyre, merr pjesë në veprime të caktuara, autorizon përgjime, sekuestre etj., u jep zgjidhje ligjore problemeve të ngutshme brenda kompetencave në ushtrimin e funksioneve të tij, sipas përkatësisë procedurale;

– Njofton menjëherë sapo vihet në dijeni drejtuesin e prokurorisë për ngjarje dhe/ose vepra kriminale të rënda të ndodhura në juridiksionin e tyre.

b) Gjatë orarit zyrtar, aktiviteti i prokurorit është zgjidhja e detyrave të ngutshme që lidhen me ndjekjen penale. Përveç sa më sipër, ai vetë apo nëpërmjet strukturave ndihmëse, ka për detyrë të marrë dhe kallëzimet me gojë që subjekte të ndryshëm mund të bëjnë drejtpërdrejtë në prokurori.

c) Pas orarit zyrtar, prokurori i gatshëm duhet të garantojë disponueshmërinë e tij në çdo kohë për zgjidhjen e detyrave të ngutshme. Me marrjen njoftim në lidhje me detyrën e ngutshme, prokurori paraqitet në institucion apo në vendin ku është e nevojshme prania e tij, për realizimin e detyrës në një kohë sa më të shpejtë. Ai organizon të gjitha strukturat përkatëse në funksion të zgjidhjes sa më të mirë të detyrës. Gjatë kësaj kohe, ai qëndron në komunikim

me të gjithë personat e përfshirë në shërbim si dhe duhet të jetë i arritshëm në çdo moment nga strukturat policore.

Neni 4

#### **Linja e kontaktit**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër identifikon një numër bazik dhe një numër celulari si numra të shërbimit të gatishmërisë. Këta numra bëhen publikë dhe u njoftohen veçanërisht strukturave policore.

### **KREU III**

#### **PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, MBIKËQYRJA, SHFUQIZIME, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI**

Neni 5

#### **Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore**

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, kur nuk përbëjnë vepër penale, mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit<sup>2</sup> dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore dhe/ose prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas ligjit.

Neni 6

#### **Zbatimi dhe mbikëqyrja**

Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse të shërbimeve dhe të seksioneve dhe punonjësit administrativë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër<sup>3</sup>.

Neni 7

#### **Shfuqizime**

Shfuqizohet çdo akt tjetër për pjesën që bie në kundërshtim me këtë udhëzim të përgjithshëm.

<sup>2</sup> Shih nenin 101, pika 1, shkronjat “a” e “b” dhe nenin 102, pika 1, shkronjat “ç”, “d”, “dh”, “ë”, “g”, “j”, “l”, “ll” e “nj” dhe pika 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” e vijues të ligjit nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr.48, të vitit 2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96, të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

<sup>3</sup> Shih nenet 46, pika 2 dhe 103 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 8

**Hyrja në fuqi dhe publikimi**

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi më datë 01.08.2024 dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

**DREJTUESI**

**ABAZ MUÇA**

